

ROLI I ZEMAHSHERIUT NË RUAJTJEN E ORIGJINALITETIT TË GJUHËS ARABE

Ridvan XHAFERI¹

¹Universiteti i Tetovës

²ridvan.xhaferi@unite.edu.mk

Abstrakti

Faktori më i rëndësishëm në qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e origjinalitetit të gjuhës arabe është Libri i Zotit të Plotfuqishëm, Kur'ani Fisnik. Janë bërë përpjekje të mëdha nga arabët dhe joarabët në interpretimin e gjuhës së fjalëve të Tij, shumë shkrintarët dhe studiues të gjuhës arabe janë të mendimit se Mahmud b. Omer Zemahsheriu bëri shumë për gjuhën arabe. Ai ishte një shkencëtar i dalluar dhe u quajt prijës i interpretuesve. Roli i Zemahsheriut në zhvillimin e shkencave të gjuhësisë dhe letërsisë arabe është i rëndësishëm, përshkak të origjinalitetit të shkrimeve dhe mendimit islam. Interpretimi i tij "Keshaf" konsiderohet një enciklopedi gjuhësore dhe retorike arabe, shumica e studiuesve e shohin atë si kryeveprën e tij. Sukses i tij është i qartë kur autori dëshmon pasurinë dhe bukurinë e gjuhës arabe nga këndvështrimi shkencor, retorik dhe stilistik.

Fjalët kyçe: *Gjuha arabe, retorika, Kur'ani, interpretimi.*

Jeta e Zemahsheriut (1075 - 1143)

Ebul Kasim Mahmud bin Umer bin Muhammed bin Ahmed Zemahsheri, i cili në literaturën islame njihet edhe me pseudonimin Xharull-llah, u lind në vitin 1075 në fshatin Zemahsher të Havarizmit (Ed-Davudi (1999): v. II, 314).

Zemahshariu është me origjinë persiane, megjithatë, ai i shkroi pothuajse të gjitha veprat e tij në gjuhën arabe, madje e konsideroi si nder t'i shërbente kësaj gjuhe me veprat e tij (Zemahsheri (1993): v. I, 17-19).

Nga disa vargje në poezitë e tij kuptohet se ai kishte origjinë nga një familje fetare. Babai i tij ishte një dijetar dhe predikues fetar lagjeje, i cili u burgos për arsye politike nga ministri Selxhuk Muejjudulmulk, ku edhe vdiq në burg.

Pa dyshim, ndriçimi për epokën e personalitetit tij qoftë ajo (politike, shoqërore, kulturore dhe intelektuale) zbulon shumë për të, gjë që na ndihmon ta kuptojmë me kujdes, nëse kuptojmë mjedisin e tij sipas gjitha rrethanave. Prandaj, të gjitha këto veçori kristalizojnë dhe formojnë për personalitetin e Zemahshariut, i cili jetoi në fund të shekullit XI dhe në fillim të shekullit XII.

Havarizmi- qendër e shkencës dhe kulturës

Pavarësisht situatës së vështirë politike dhe shoqërore të epokës së Zemahsheriut, çështja ishte krejtësisht ndryshe për sa i përket kushteve kulturore dhe intelektuale, pasi shkollat dhe bibliotekat ekzistonin, studiuesit ishin të zënë me artet e ndryshme të dijes, tubime dhe diskutime

të mrekullueshme të teksteve, diskutime të librave dhe grupimeve të ndryshme. Kjo rilindje përfshiu pjesën më të madhe të popullsisë së vendit, duke përfshirë Havarizmin, në të cilin jetoi dhe u ngrit intelektualisht shkencëtari Zemahsheri.

Prandaj, epoka e Zemahsheriut rezultoi me prijës të mëdhenj që lulëzuan në arte të ndryshme të dijes, pasi ata kontribuan në përhapjen e kulturës dhe pasurimin e mendimit, siç ishin: Ibn Atija el-Andelusi, Shatibi, El-Begavi El-Farra, Gazali, Ibn Tufail, El-Sarahsi, Ibn Arabi, El-Kadi Ijad, Tabrizi, Ibn Esh-Shexherijj, El -Hariri, Ibn Hafaxhe, Es-Sem'ani dhe Ibn Asakir.

Që nga mosha rinore u shpërngul në Bagdad, ku takoi dijetarët të mëdhenj të kohës, prej të cilëve mori mësim në shumë shkencë. Pas një kohe u bë i dalluar në shkencat e ekzegjezës, transmetime të fjalëve profetike, gramatikë (sintaksë-morfologji) dhe letërsisë arabe. Pa dyshim, është një prej dijetarëve më të shquar që pati ndonjëherë bota islame. Vdiq në natën e Arefatit, në vitin 1143 në Xhurxhane të Havarizmit. (Zemahsheri (2004): 270-275).

Pak fjalë për gjuhën arabe

Gjuha është sistem i simboleve dhe paraqitet si prodhim i pajtimit të një populli të caktuar në lidhje me perceptimin e simboleve të caktuara. Ky konstatim është valid për të gjitha gjuhët e botës, por njëkohësisht i ngërthen edhe trajtat tjera të komunikimit. Domethënë komunikimi ndërmjet njerëzve bëhet në bazë të përkapjes së përbashkët të simboleve të caktuara. Gjuha e vjetër arabe është përdorur në Jemen, kryesisht prej shek. I-IV, si edhe në mbishkrimet në Mekë nga viti 328. Dokumentet më të vjetra të gjuhës së re arabe datojnë qysh nga shekulli IV para erës së re, por formën e përsosur e cila përdoret edhe sot, e mori nga Kur'ani (F. Mehdiu (1990): 7).

Gjuha arabe i takon familjes së grupit të gjuhëve semite, të cilat kanë një histori të regjistruar prej mijëra vjetësh. Në grupin e gjuhëve semite bën pjesë gjuha hebraike, si dhe gjuha aremeje. Para zbritjes së Kur'anit, arabishtja ka qenë anëtare e vogël e familjes së gjuhëve semite, e cila përdorej nga një numër i vogël fisesh nomade të shpërndara në Gadishullin Arabik. Rritja e gjuhës arabe dhe përhapja e saj deri në shkallën e gjuhëve të gjalla në botë është e ndërlidhur me vetë shfaqjen e islamit si një ndër fetë dominante në botë (K. Hoxha (2009): 6).

Veprat e Zemahsheriut në fushën e gjuhës arabe

Që nga fëmijëria e tij, Zemahsheri ishte i dhënë pas shkencës dhe kërkimit, ndërkohë, ai udhëtoi në shumë pjesë të Gadishullit Arabik. Gjatë udhëtimeve të tij ai u interesua për fiset arabe; fitoi njohuri të gjëra për hollësitë dhe dialektet e ndryshme të arabishtes. Pas vetes la trashëgimi të madhe veprash dhe bibliotek të pasur në shkencë të ndryshme, të cilat emrin e tij e bënë të njohur në të gjitha provincat islame, por duke dominuar në gramatikë, gjuhë, letërsi, fjalë të urta dhe predikime.

Ai kishte njohuri të gjëra në shkencat si shekencën e hadithit, jurisprudencën islame, teologji spekulative (kelam) dhe ekzegjezën kur'anore. Është një personalitet me autoritet që është pranuar veçanërisht në gjuhën dhe letërsinë arabe, megjithëse nuk është me origjinë arabe, ai përshkruhet si Shejhu-l-Arabi (Mësuesi arab).

Vepra që e nxori emrin e tij në mesin e dijetarëve të islamë, është *ekzegjeza* e njohur në qarqet shkencore: “*El Keshafu an hakaiki-t-tenzili ve ujuni-l ekavili fi vuxhuhi-t-te'vili*”.

Në shkencat e gjuhës arabe dhe letërsi shkroi këta vepra:

1. El-Mufas-sal fi sina'ati'l-i'rab.
2. El-Unmudhexh.
3. El-Mufred ve'l-mu'el-lef (el-Mufred ve'l-murek-keb).
4. Mes'ele (Risale) fi kelimeti'sh-Shehade.

5. El-Muhaxhat (el-Muhaxhat) bi'l-mesa'ili'n-nahvije (el-Ehaxhi'n-nahvije).
6. Sherhu Ebjati Kitabi Sibevejhi.
7. Mukaddimetu'l-Edeb.
8. Esasu'l-Belaga.
9. Kitabu'l-Xhibal ve'l-emkine ve'l-mijah.
10. Divanu'sh-shi'r (Divanu'l-Edeb).
11. Axhebu'l Axheb fisherhi Lamijeti'l-Arab.
12. El-Mustaksa fi'l-emsal (el-Mustaksafi emthali'l-Arab).
13. Nevabigu'l-Kelim (el-Kelimu'n-Nevabig).
14. Ed-Durru'd-dair el-muntehab fi kinajati ve'stiarati ve'teshbihati'l-'Arab.
15. El-Kustasu'l-Mustakim fi'l-'Arud
16. Kaside fimes'ali'l-Gazali
(Zemahsheri (1891): v. I, 15-19).

Retorika dhe gjuha arabe te Zenasheriu

Sipas Zemahsheriut njohja semantikës dhe stilistikës së gjuhës arabe është thelbësore për të kuptuar kuptimet më të hollësishme të Kur'anit. Ai mendon se "askush nuk mund t'i kuptojë domethëniet e vërteta, përveç një personi që është i aftë në dy shkenca që lidhen me Kur'anin, dhe ato janë shkenca e semantikës dhe stilistikës". Megjithatë ajo që bën autori në këtë veper është analizë e përpiktë e fjalëve, koncepteve, shpjegimet e mrekullueshme brenda kornizës së gjuhës dhe letërsisë arabe.

Me përhapjen e islamit te joarabët, filluan të shfaqen disa gabime në gjuhën arabe, libri dhe gjuha arabe kërkonte mbrojtje në një mënyrë të organizuar shkencore. Kjo dukuri filloi në periudhën e fundit të sundimit Emevijt dhe u intensifikua edhe në periudhën e parë të sundimit Abasit, ku në këtë periudhë u përkthyen shumë vepra nga gjuhët tjera në gjuhën arabe, martesat të përziera dhe kulturat e huaja që u prezantuan te arabët ishte motiv për afërsinë e popujve tjerë me arabët që nuk ishte më herët. Në këtë drejtim për ta ndihmuar gjuhën arabe rëndësi të veçantë dhanë shkolla e Basrës dhe e Kufës që u shfaqën në periudhën e shek IX, në këtë periudhë u shfaqën studiues të gramatikës si Ibn Kejsi (320/932), Ibn Xhinni (392/2002) dhe Zemahsheri (547/1075). Zemahsheriu shqyrtoi pikpamjet e shumë studiuesve të gjuhës para tij, ku disa nga ata i kritikoi e disa prej tyre i mbështeti. Ai shprehi idetë, pikëpamjet dhe preferencat e tij origjinale gjuhësore në veprat e tij, e në veçanti veprat "*Keshaf*", "*Mufassal*" dhe "*Esasul Belaga*", që konsiderohen si vepra më të përsosur e të shkruara në gramatikën arabe dhe që demonstroi autoritetin në kohën e tij përshkak stilit të lehtë dhe përmbajtjes së tij të pasur.

Dihet se shkencat që Zemahsheri u preku në interpretimin e Kur'anit fisnik janë shkencat retorike dhe gjuhësore, dhe kjo është e lidhur ngushtë me mrekullitë dhe elokuencën e Kur'anit Fisnik. Kur'ani është libër në gjuhën arabe dhe mrekullia e tij e përjetshme.

Zoti i sfidoi arabët por edhe gjithë njerëzimin, të sjellin qoftë të paktën edhe një kaptinë ose verset të ngjashëm si fjala e Zotit, por njeriu nuk mundi të sjell diç të ngjashëm. Kjo sfidë ekzistonte dhe vazhdon ende, pavarësisht kalimit të disa shekujve, siç ka thënë Zoti i Madhëruar: "Dhe nëse jeni në dyshim për atë që ia kemi shpallur robit tonë, atëherë ejani me një sure të tillë dhe thirrni dëshmitarët tuaj, nëse jeni të sigurtë".

Kjo mrekulli, dhe arsyeja e paaftësisë së arabëve dhe njerëzve nëpërgjithësi për të sjell diç si Kur'ani, është tema të cilën Zemahshari u përpoq ta tregonte në librin e tij "*Keshaf*", vazhdoi mendimin e tij dhe e trajtoi atë gjërësisht në interpretimin e gjitha ajeteve Kur'anore.

Hulumtimi në Librin e Zotit është hulumtimi më i mirë që mund të bëhen në shkencat dhe artet arabe. Dihet se Zemahshari bëri një përpjekje të jashtëzakonshme retorike në interpretimin e tij “*Keshaf*” që është dëshmia më e mirë për temën në fjalë dhe bëri një shërbim të madh fjalës së Zotit dhe gjuhës arabe.

Zemahsheri u ngrit dhe madhërua në sytë e shumë dijetarëve, El-Sem'ani thotë: “*Ai ishte shembull në letërsi dhe gramatikë*” (Sem'ani (1999): 277), Ibn Halkani thotë: “*Ishte Imam i kohës që udhëtonte në artet e tij*” (Ibn Halkan (1970): v. II, 107), Jakuti thotë: “*Ai ishte Imam dhe kishte merita të mëdha në interpretim, gramatik, gjuhë dhe zotëronte shkenca të ndryshme*” (Jakut (1993): v. XIX, 470-471), Ahmed Emin thotë: “*Ai arriti kulmin në interpretimin racional*” (A. Emin (1993): v.II, 42).

Gjuhën dhe gramatikën e trajtoi mbi baza shkencore, kjo e bëri që ai të preferonte arsyen mbi transmetimin, e trajtoi këtë me argumente verbale, dialektike, logjike dhe filozofike (M. Safa el-Xhuvjeni (2018): 28).

Përfundimi

Gjuha arabe i takon familjes së grupit të gjuhëve semite, ku bëjnë pjesë edhe gjuha hebraike e gjuha aremeje. Para zbritjes së Kur'anit, arabishtja ka qenë anëtare e vogël e familjes së gjuhëve semite, e cila përdorej nga një numër i vogël fisesh nomade të shpërndara në Gadishullin Arabik.

Zemahsheri kishte njohuri të gjëra në shkencat si shekencën e hadithit, jurisprudencën islame, teologji spekulative (kelam) dhe ekzegjzën kur'anore. Vepra kryesore e tij është ekzegjeza e tij e mirënjohur në qarqet shkencore: “*El Keshafu an hakaiki-t-tenzili ve ujuni-l ekavili fi vuxhuhi-t-te'vili*”. Sipas Zemahsherit njohja semantikës dhe stilistikës së gjuhës arabe është thelbësore për të kuptuar kuptimet më të hollësishme të Kur'anit. Ai shprehi idetë, pikëpamjet dhe preferencat e tij origjinale gjuhësore në veprat e tij, e në veçanti veprat “*Keshaf*”, “*Mufassal*” dhe “*Esasul Belaga*”, që konsiderohen si vepra më të përsosur e të shkruara në gramatikën arabe.

Literatura e shfrytëzuar:

- [1]. Ed-Davudi “*Tabekatul mufessirine*”, v. II, Bejrut, 1999.
- [2]. Zemahsheri, *el-Mufassal*, vell.I, 17-19, Bejrut 1993.
- [3]. Zemahsheri, *Divan*, Kairo, 2004.
- [4]. Feti Mehdiu, *Gjuha arabe fonetikë-morfologji*, Prishtinë, 1990.
- [5]. Kadri Hoxha, *Metodë dhe gramatikë e gjuhës arabe*, Prishtinë, 2009.
- [6]. Zemahsheri “*El-Kesh-shaf*”, v. I, Kajro 1308 h
- [7]. Zemahsheri, *Mufassal fi sana el-I'rab*, Bejrut, 1999.
- [8]. Sem'ani, *El-En-sab*, Bejrut, 1999.
- [9]. Ibn Halkan, *Vefejat el-A'jan*, v. 2, Bejrut, 1970.
- [10]. Jakut, *Mu'xhemul Udeba*, v. 19, Darul Garb, 1993.
- [11]. Ahmed Emin, *Dhahr el-Islam*, v. 2, Bejrut, 1993.
- [12]. Mustafa Safa el-Xhuvjeni, *Menhexh ez-Zemhasheri fi tefsir el-Kuran ve bejan Ixhazih*, Kajro, 2018.